



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 7989 Prot.

Tiranë, më 25.11.2024

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 112, datë 25.11.2024

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Albaphoto" Shpk, me NIPT K86618008S, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi në procedurën e prokurimit me objekt: "*Mobilim i spitalit të ri të ndërtuar (A2), në QSUT*", të zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë (në vijim "AK") dhe në përfundim të saj ka nënshkruar kontratën Nr. 1387/22 Prot., datë 27.09.2022, Loti 6, me objekt: "*Furnizim vendosje e aparaturave mjekësore për spitalin e ri "Kabineti i Endoskopisë"*" me vlerë 17.184.000 lekë më Tvsh.

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa): "Albaphoto" Shpk, me NIPT K86618008S, me adresë: Rruga "Kol Indromeno", Nd. 89, H. 3, Ap. 30, Shkodër.

I. Arsyt e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Albaphoto" Shpk, me NIPT K86618008S, ka nisur bazuar në shkresën e dërguar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me Nr. 1177/30 Prot., datë 22.12.2023, me objekt: "*Kërkohet fillimi i hetimit administrativ*", mbi auditimin e ushtruar në AK.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e nenit 78/1/a të LPP, ku parashikohet se: "*Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi*".

III. Masat:

Me Vendimin Nr. 112, datë 25.11.2024, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Albaphoto" Shpk, me NIPT K86618008S, nga e drejta për të fituar kontrata publike, **për 2 (dy) vjet** nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.